Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0651

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) EING COM SH.P.K., kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet''-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, me 30/10/2026, mori:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE EING COM SH.P.K. me nr. 2026/0651 , e datës 27/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet''-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

2.Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit "163 Ndërtimi,rregullimi,vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet''-Ritender me numër të prokurimit 616-25-2547-1-1-1 kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 5 ditësh, AK obligohet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik EING COM SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.003.2025. Kuvendi i Komunës së Prishtinës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit: "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender", me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1,

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, me lloj të kontratës: furnizim, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është 2,000,000.00 €

Me 07.08.20206 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi anulimin (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 12.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.08.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.08.2026, OE EING COM SH.P.K." ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0651, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EING COM SH.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendime me përfundime mbi bazën e dyshimeve dhe hamendësimeve, pa identifikuar dhe administruar prova konkrete që do të dëshmonin papërgjegjshmërinë e ofertës sonë duke e ditur qe kete pike per kete qeshtje e kemi sqaruar per AK me date: 02.06.2025. Per me teper sa i perket sqarimit te dokumentit ne fjale i kemi paraqitur te dhenat e adresimit ku mund të verifikohen në mënyrë të besueshme ky dokument me te gjitha elementet e nevojshme. Prandaj AK ka mundur lehtesisht te kerkon sqarime ose edhe ta verifikon vet me qenese te gjitha sqarimet per kete qeshtje i kemi ofruar te AK. Siq shihet ne arsyen e dhene nga AK, ku thuhet se: Mungesa e përgjigjes brenda afatit të njëanshëm prej tri ditësh, të caktuar nga vetë AK-ja, nuk përbën provë se dokumenti është i pavlefshëm, joautentik apo i papërshtatshëm.

Për më tepër, AK nuk ka identifikuar se cilat janë "provat dhe informacionet e tjera relevante" mbi të cilat pretendon se e ka mbështetur këtë përfundim, duke qenese dokumenti eshte i prezentuar se bashku ne oferten ton dhe per te njejtin kemi dhene sqarime me date: 02.06.2025. Gjithesesi me qenese keto dokumente sigurohen nga nje pale e trete jashte Kosoves dhe ne kemi kerkuar edhe njehere ta na i rikonfirmojn te nejtat dokumente, leshuesit te dokumenteve perkatese dhe ne momentin e pranimit do i bashkangjesim edhe njehere per ta sqaruar per ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues. 6/1 F02 Formulari Standard për ankesë në OSHP

Pretendimi 2: Çështja e dokumentit tatimor: Lidhur me kete AK duhet ta kete te qarte se kjo qeshjte eshte trajtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, me c'rast ka Vendim perfundimtar lidhur me kete qeshtje dhe eshte e pakuptimt te vazhdohet me keto pretendime te paqena dhe tendencioze. Kjo çështje është shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimin e OSHP-së PSH.nr.676/26, ku kërkesa e AK-së për diskualifikimin e GOE-së është refuzuar si e pabazuar. Po ashtu, vendimi OSHP:2026/0311 ka trajtuar natyrën dhe fazën procedurale të dokumentit tatimor, duke konstatuar se dëshmitë e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së kërkohen nga tenderuesi që AK synon ta rekomandojë për kontratë, para publikimit të B58-së. Sipas këtij vendimi, dokumenti nuk është dashur të përdoret si kriter i drejtpërdrejtë eliminues pa u respektuar procedura për kërkimin, dorëzimin dhe verifikimin e dëshmive të pranueshmërisë. Vendimi zyrtar OSHP:2026/0311 ashtu siq eshte potencuar ne kete vendim.

Prandaj, AK jo vetëm që po përsërit një pretendim të trajtuar më parë, por po përdor përsëri të njëjtën çështje si bazë për eliminim, në kundërshtim me konstatimet dhe udhëzimet e OSHP-së. Provë 1: 7/1 F02 Formulari Standard për ankesë në OSHP Provë 2: Provë 3: 8/1 F02 Formulari Standard për ankesë në OSHP Provë 4:

Pretendimi 3: Kundërshtimi i arsyes për mungesë të mjeteve financiare Nuk qëndron as pretendimi i AK-së se për vitin fiskal 2026 "nuk janë të alokuara mjete financiare" për realizimin e këtij projekti, duke qenese gjate inicimit te aktivitetit te prokurimit kerkohet rreptesisht qe: Neni 8.1 i RRPP-se percakton: Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve kontraktuese bëhet në pajtueshmëri me Nenit 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike. "Alokimi"do të thotë këtu "shuma është autorizuar", në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuar është që të përmirësohet efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde të alokuar thjesht mund të jetë humbje e resurseve.

Prandaj mbi kete baze AK ka inicuar kete aktivite te prokurimit duke u mbeshtetur ne dispizitat perkatese dhe kjo provë e paraqitur nga ana jone e kundërshton drejtpërdrejt konstatimin e AK së se nuk ekzistojnë mjete të alokuara për këtë projekt. AK ka perdorur si argument procedurat e shqyrtimit te OSHP-se si fakt per rrethana te reja duke qense i gjith ky proces eshte zvarrit nga ana juaj per te krijuar situata te tilla dhe kjo eshte e papranueshme duke qene se kater Vendime te OSHP-se nuk i ka zbatuar dhe kjo perben shkelje te rende te dispozitave ligjore per prokurimin publik. Provë 4 – Ky projekt është përfshirë në Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2026, në këtë kategori: Kategoria: Investime kapitale Drejtoria: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit Pozicioni: Nr. 10 Emërtimi: "Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet" Buxheti total për vitin 2026: 500,000.00 € 200,000.00 € nga Granti i Përgjithshëm 300,000.00 € nga Burimet Vetanake Lënda të kthehet në RIVLERËSIM duke respektuar Vendimet e OSHP-se dhe te marrë në konsiderat të gjitha sqarimet e dhena nga ana jone.

Pra, aktiviteti i prokurimit me vlerë të parashikuar 2,000,000.00 € mbështetet në vitin 2026 me ndarje buxhetore prej 500,000.00 €. Diferenca duhet të mbulohet përmes zotimeve shumëvjeçare ose buxheteve të viteve pasuese, varësisht nga kontrata dhe planifikimi financiar. Po ashtu mosdhënia e qasjes në dokumente na bene te dyshojm ne gjith kete proces te inskenuar nga autoriteti kontraktues me situata dhe rrethana te paqena. Prandaj bazuar ne sqarimet e dhena me

larte, kërkojmë nga eskperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues që ta kthej lënden në rivlerësim si dhe ta detyroj dhe ta Urdheroj Autoritin Kontraktues qe ta beje Ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave te nenit 59 te LPP-se si dhe konfrom vendimeve te OSHP-se.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendime me përfundime mbi bazën e dyshimeve dhe hamendësimeve, pa identifikuar dhe administruar prova konkrete që do të dëshmonin e ofertës sonë, duke e ditur që këtë pikë për këtë çështje e kemi sqaruar për AK me datë: 02.06.2025. Për më tepër, sa i përket sqarimit të dokumentit në fjalë, i kemi paraqitur të dhënat e adresimit ku mund të verifikohen në mënyrë të besueshme ky dokument me të gjitha elementet e nevojshme. Prandaj AK ka mundur lehtësisht të kërkojë sqarime ose edhe ta verifikojë vetë, meqenëse të gjitha sqarimet për këtë çështje i kemi ofruar te AK. Siç shihet në arsyen e dhënë nga AK, ku thuhet se: Mungesa e përgjigjes brenda afatit të njëanshëm prej tri ditësh, të caktuar nga vetë AK-ja, nuk përbën provë se dokumenti është i pavlefshëm, joautentik apo i papërshtatshëm. Për më tepër, AK nuk ka identifikuar se cilat janë "provat dhe informacionet e tjera relevante" mbi të cilat pretendon se e ka mbështetur këtë përfundim, nga kush janë siguruar, kur janë siguruar dhe çfarë përmbajtje kanë, sepse për të gjitha këto AK ka mundur ti sqarojë me ne para se të nxjerrë vendim për eliminimin tonë.

Pretendimi 2: Çështja e dokumentit tatimor: Lidhur me këtë AK duhet ta ketë të qartë se kjo çështje është trajtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, me çrast ka Vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje dhe është e pakuptimtë të vazhdohet me këto pretendime të paqena dhe tendencioze. Kjo çështje është shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimin e OSHP-së PSH.nr.676/26, ku kërkesa e AK-së për diskualifikimin e GOE-së është refuzuar si e pabazuar. Po ashtu, vendimi OSHP:2026/0311 ka trajtuar natyrën dhe fazën procedurale të dokumentit tatimor, duke konstatuar se dëshmitë e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së kërkohen nga tenderuesi që AK synon ta rekomandojë për kontratë, para publikimit të B58-së. Sipas këtij vendimi, dokumenti nuk është dashur të përdoret si kriter i drejtpërdrejtë eliminues pa u respektuar procedura për kërkimin, dorëzimin dhe verifikimin e dëshmive të pranueshmërisë. Vendimi OSHP:2026/0311, ashtu siç është potencuar në këtë vendim.

Pretendimi 3: Kundërshtimi i arsyes për mungesë të mjeteve financiare

Nuk qëndron as pretendimi i AK-së se për vitin fiskal 2026 "nuk janë të alokuara mjete financiare" për realizimin e këtij projekti, duke qenë se gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit kërkohet rreptësisht që: Neni 8.1 i RRPP-së përcakton: Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve kontraktuese bëhet në pajtueshmëri me Nenin 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZI<F do të sigurojë që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.

"Alokimi" do të thotë këtu "shuma është autorizuar", në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuara është që të përmirësohet efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde të alokuara thjesht mund të jetë humbje e resurseve. Prandaj, mbi këtë bazë AK ka iniciuar këtë aktivitet të prokurimit.

Fillimisht duhet sqaruar se ky aktivitet i prokurimit është anuluar për shkak të mungesës së mjeteve financiare të planifikuara për vitin fiskal 2026. Aktiviteti i prokurimit është zgjatur përtej afateve të parapara dhe, si rezultat, nuk ekzistojnë mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e tij gjatë vitit fiskal 2026. Në anën tjetër, parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për arsyet e evidentuara në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Sidoqoftë, pretendimet ankimore pas shqyrtimit janë gjetur si të pabazuara. Me fjalë të tjera, vlerësimi i komisionit ka qenë plotësisht i drejtë dhe si i tillë ka qenë edhe në përputhje me vendimin e OSHP-së të nxjerrë gjatë kësaj procedure.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.08.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0651, ndërsa me datë 30.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0651, me rekomandimet si në vijim:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e "EING COM SH.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0651 ka vlerësuar si në vijim:

Më datën 27.08.2026, G.O.E. "EING COM" SH.P.K. & "MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI" A.S. ka paraqitur ankesë në OSHP lidhur me aktivitetin e prokurimit "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender", me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

GOE ankues kundërshton eliminimin e ofertës së tij dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke pretenduar se AK nuk ka respektuar vendimmarrjen paraprake të OSHP-së dhe se veprimet e ndërmarra janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 (RrPP).

Në ankesë pretendohet shkelja e neneve 1, 6, 7, 59, 62, 69 dhe 72 të LPP-së, si dhe e neneve 40.2.1 dhe 43 të RrPP-së.

II. PRETENDIMET ANKIMORE

Nga përmbajtja e ankesës rezulton se GOE ankues i ka strukturuar pretendimet ankimore në tri çështje kryesore:

Pretendimi ankimor nr. 1:GOE ankues kundërshton arsyetimin e AK-së lidhur me dokumentin "Inspection Report Nr. 314 R", duke pretenduar se AK ka nxjerrë përfundime mbi bazën e dyshimeve, pa administruar prova konkrete që do të dëshmonin papërgjegjshmërinë e ofertës. Ankuesi thekson se kjo çështje ishte sqaruar pranë AK-së më 02.06.2025 dhe se ishin ofruar të dhënat për verifikimin e dokumentit. Sipas tij, mungesa e përgjigjes brenda afatit të caktuar nga AK nuk përbën provë se dokumenti është i pavlefshëm apo joautentik, ndërsa AK nuk ka identifikuar konkretisht "provat dhe informacionet e tjera relevante" mbi të cilat ka mbështetur përfundimin e tij.

Pretendimi ankimor nr. 2:GOE ankues kundërshton përdorimin e dokumentit tatimor si arsye eliminimi, duke pretenduar se kjo çështje ka qenë tashmë objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje nga OSHP-ja. Ankuesi i referohet Vendimit PSH nr. 676/26, me të cilin kërkesa e AK-së për diskualifikim është refuzuar si e pabazuar, si dhe vendimit OSHP:2026/0311 lidhur me trajtimin procedural të dëshmive sipas nenit 65 të LPP-së. Sipas ankuesit, AK po përdor përsëri si bazë eliminimi një çështje të trajtuar më parë nga Paneli Shqyrtues.

Pretendimi ankimor nr. 3;GOE ankues kundërshton arsyen e anulimit që lidhet me mungesën ose pamjaftueshmërinë e mjeteve financiare për vitin fiskal 2026. Ankuesi pretendon se aktiviteti është iniciuar në bazë të disponueshmërisë së fondeve, duke iu referuar nenit 8.1 të RrPP-së dhe nenit 9 të LPP-së. Po ashtu, thekson se projekti është i përfshirë në Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2026 dhe se zgjatja e procedurës për shkak të proceseve shqyrtuese nuk mund të përdoret si rrethanë e re për anulimin e aktivitetit.

Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi i referohet ndarjes buxhetore të evidentuar për projektin në vitin 2026 dhe ngre gjithashtu çështjen e mosdhënies së qasjes në dokumentacionin mbi të cilin AK ka mbështetur vendimmarrjen.

Në përfundim, GOE ankues kërkon aprovimin e ankesës si të bazuar, anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së – B58, të datës 07.08.2026, dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, duke kërkuar që AK të veprojë në përputhje me vendimet paraprake të OSHP-së dhe sqarimet e paraqitura nga ankuesi.

III. VLERËSIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të procedurës aktuale, pretendimeve ankimore, arsyetimit të Autoritetit Kontraktues, si dhe vendimeve paraprake të OSHP-së që ndërlidhen me të njëjtin aktivitet të prokurimit, vëren se kjo procedurë ka qenë disa

herë objekt shqyrtimi pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Në radhë të parë, eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me një pjesë të arsyeve të eliminimit të GOE ankues ekziston vendimmarrje paraprake e Panelit Shqyrtues. Me vendimet OSHP nr. 2025/0535 dhe 2025/0560, të datës 19.08.2025, si dhe me vendimin OSHP nr. 2026/0027, të datës 26.02.2026, Paneli Shqyrtues ka trajtuar arsyet eliminuese të përdorura nga AK dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Po ashtu, me vendimin lidhur me lëndët OSHP:2026/0311 dhe OSHP:2026/0322, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se çështjet që lidhen me GOE ankues ishin trajtuar përmes vendimeve paraprake nr. 2025/0535, 2025/0560 dhe 2026/0027 dhe i kishte konsideruar si çështje të gjykuara – res judicata.

Në këto rrethana, sa i përket çështjeve të cilat tashmë kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Panelit Shqyrtues, eksperti shqyrtues nuk e konsideron të nevojshme që të bëhet një vlerësim i përsëritur i tyre në kuadër të kësaj ekspertize.

Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor nr. 1;Sa i përket dokumentit “Inspection Report Nr. 314 R”, Ref. IDD.1035.10.A41, eksperti shqyrtues vëren se kjo çështje ka qenë objekt sqarimi edhe gjatë vlerësimit fillestar të ofertës. Me Letrën Standarde të datës 27.05.2025, AK i kishte kërkuar GOE ankues sqarime lidhur me raportin e paraqitur dhe të dhëna për verifikimin e institutit lëshues.

Me përgjigjen e datës 02.06.2025, GOE ankues kishte sqaruar se raporti ishte lëshuar nga Bureau Veritas, kishte identifikuar MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI A.S. si kërkues të inspektimit dhe prodhues të sistemit “Flood Boom”, si dhe kishte ofruar të dhëna për verifikimin e dokumentit.

Në rivlerësimin aktual, AK ka ndërmarrë veprime shtesë verifikuese, duke iu drejtuar më datë 03.08.2026 Bureau Veritas me kërkesë për konfirmimin e lëshimit dhe autenticitetit të dokumentit. Eksperti shqyrtues vlerëson se, në pajtim me nenin 52.7 të LPP-së, AK, në rast të dyshimit lidhur me informacionin apo dokumentacionin e dorëzuar, mund të kryejë kontroll efektiv të tij.

Megjithatë, në rastin konkret, sipas vetë arsyetimit të AK-së, deri në momentin e marrjes së vendimit nuk është pranuar përgjigje zyrtare nga Bureau Veritas. Për këtë arsye, mungesa e një përgjigjeje të tillë, në vetvete, nuk mund të shërbejë si provë e mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se dokumenti është joautentik apo i pavlefshëm.

Po ashtu, ndonëse AK i referohet edhe “provave dhe informacioneve të tjera relevante”, nga arsyetimi i vendimit nuk rezulton të jenë identifikuar konkretisht këto prova dhe rëndësia e tyre në përfundimin e arritur.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nr. 1 është i bazuar, pasi arsyetimi i AK-së lidhur me këtë dokument nuk rezulton të jetë mbështetur në prova të mjaftueshme dhe të identifikuara qartë.

Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor nr. 2:Sa i përket dokumentit “Income Tax and VAT Clearance Certificate 2025 – Mavi Deniz (Final)”, eksperti shqyrtues vëren se kjo çështje ka qenë objekt i vendimmarrjes paraprake të Panelit Shqyrtues.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues kishte paraqitur kërkesë për marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-së, ndërsa me Vendimin PSH nr. 676/26, të datës 28.07.2026, Paneli Shqyrtues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për diskualifikim, duke konstatuar, ndër të tjera, se AK nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar se MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI A.S. kishte mashtruar apo falsifikuar ndonjë dëshmi.

Për këtë çështje, eksperti shqyrtues i referohet vendimmarrjes së Panelit Shqyrtues, përkatësisht Vendimit PSH nr. 676/26.

Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor nr. 3:Sa i përket anulimit të aktivitetit të prokurimit për pamjaftueshmëri të mjeteve financiare për vitin fiskal 2026, eksperti shqyrtues vëren se kjo paraqet rrethanë të re në raport me vendimmarrjen paraprake të OSHP-së.

Nga Dosja e Tenderit rezulton se aktiviteti është zhvilluar për lidhjen e një kontrate publike kornizë – furnizim, me një operator ekonomik, me kohëzgjatje prej 12 muajsh nga data e hyrjes në fuqi, ndërsa realizimi i saj bëhet përmes urdhërblerjeve të lëshuara sipas nevojës gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi për pamjaftueshmërinë e mjeteve financiare do të duhej të sqaronte konkretisht gjendjen e mjeteve të disponueshme në momentin e vendimmarrjes, obligimet që pritej të krijoheshin gjatë pjesës së mbetur të vitit 2026, si dhe ndikimin e natyrës 12-mujore të kontratës publike kornizë.

Nga arsyetimi i AK-së nuk rezulton të jetë paraqitur një analizë e tillë në masë të mjaftueshme. Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nr. 3, sa i përket arsyes së anulimit për pamjaftueshmëri të mjeteve financiare, është i bazuar, pasi kjo arsye, ashtu siç është paraqitur nga AK, nuk është arsyetuar në masë të mjaftueshme në raport me natyrën, kohëzgjatjen dhe mënyrën e realizimit të kontratës publike kornizë.

Sa i përket pretendimit për mosdhënien e qasjes në dokumentacion, nga dokumentacioni i administruar në këtë ekspertizë nuk rezulton bazë e mjaftueshme për të konstatuar nëse dhe në çfarë mase AK ka refuzuar qasjen e kërkuar. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të vlerësohet si i bazuar mbi dokumentacionin e administruar në këtë ekspertizë.

IV. PËRFUNDIMI

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e GOE ankues është e bazuar. Sa i përket çështjeve të trajtuara më parë nga Paneli Shqyrtues, eksperti i referohet vendimmarrjes paraprake të OSHP-së, ndërsa lidhur me rrethanat e reja vlerëson se arsyetimi i AK-së për dokumentin “Inspection Report Nr. 314 R” dhe për anulimin e aktivitetit për mungesë të mjeteve financiare nuk është mbështetur në masë të mjaftueshme. Andaj, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit : “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve

dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender", me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1,

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit vëren se Autoriteti Kontraktues / Komuna e Prishtinës, dhe përgjegjesit e saj nuk i zbatojn vendimet e OSHP, me çrast OSHP disa herë ballafaqohen me përsëritje të ankesave sikurse edhe në këtë procedur dhe nga të njëjtat palë pjesë të procedures .ku këto veprime janë në kundërshtim fillimisht me neni 1 të LPP, duke prolonguar qëllimisht aktivitetet e prokurimit, po ashtu janë në kundërshtim edhe me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit ka nxerur disa vendime nr. 2025/0535 dhe 2025/0560, të datës 19.08.2025; vendimin nr. 2026/0027, të datës 26.02.2026; si dhe vendimet nr. 2026/0311 dhe 2026/0322, të datës 06.07.2026, ku AK-ja nga publikimi i kësaj procedure (28.03.2025) mbi një (1) vjet e shtatë (7) muaj dhe vazhdimisht ka eliminuar OE ankues për arsye të ndryshme, ndërsa së fundi me datën 07.08.2026 publikon B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se për anulimin e aktivitetit për mungesë të mjeteve financiare për vitin 2026, mirpo nuk ka asnjë provë që dëshmohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ, dhe Zyrtari Kryesor Financiar për çka Paneli Shqyrtues konsideron qe AK qëllimishtë ka zvaritur këtë procedur duke mos i respektuar afatet ligjore sikurse parashihen në dispozitat ligjore në LPP-së dhe Rregulloren për Prokurim publik. Për çka dhe i shqipton vërejtje ZPP-se dhe AK-se, në të kundërtën në rastë të përsëritjeve OSHP do të mer masa konform nenit 105, 118 , 131 të Ligjit të Prokurimit Publik, nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik, dhe Rregullorës se Punes së OSHP-se 18/20 .

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se për anulim të aktivitetit, dhe kërkohet që lënda të kthehet në ri-vlersim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- OE - **EING COM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: